



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202300638/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë Devoll.*

Drejtuar: **Z. Edvin PEÇI**
Shef i Komisaratis të Policisë

DEVOLL

Për dijeni: **Drejtues i Parë Z. Gjovalin LOKA**
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

KORÇË

Të nderuar zotërinj,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Komisaratin e Policisë Devoll nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu inspektimin në Komisaratin e Policisë Devoll, në datën 06.07.2023 sipas një Plani Inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Hazbi Selita, me detyrë Nd/komisionerë, dhe z. Rexhep Lala, ekspert i jashtëm pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimin dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, procedurën standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrorë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e Komisarariatit, z. Edvin Peci, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit. Është për tu theksuar se inspektimi ishte i pa njoftuar paraprakisht dhe nisur nga dinamika e institucionit kjo situatë është konsideruar brenda normalitetit të punës.

Pasi u njoh me qëllimin e inspektimit, shefi i komisarariatit informoi grupin e inspektimit në lidhje me kushtet në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit, angazhimin e punonjësve të policisë së këtij komisaritati për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente.

Po ashtu, nga ana e Komisarariatit të Policisë Devoll ishin bërë përpjekjet e nevojshme duke ju drejtuar organeve eprore me kërkesa për të mundësuar realizimin e investimeve në këtë institucion në kuadrin e përmirësimit të mëtejshëm të ambienteve të shoqërimit për të garantuar respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, por sërish nuk kishte asnjë ndryshim në kuadrin e çeljes së fondeve të dedikuara për këtë institucion.

Grupi i inspektimit u njoh gjithashtu edhe me veprimtarinë administrative edhe kërkesat për investim drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, lidhur me krijimin e kushteve sipas standardeve për krijimin e dhomave të shoqërimit sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe aktit të procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për të rritur, gra, si dhe për të mitur, duke krijuar mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera.

Grupi i inspektimit, vijoi inspektimin në ambientet e shoqërimit të komisarariatit, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar të arrestuar apo të ndaluar.

Gjithashtu, z. Peci angazhoi edhe punonjësit e policisë së ambienteve të shoqërimit të këtij institucioni që të ishin prezent për të bashkëpunuar dhe për të shërbyer në vijim të procesit të inspektimit. Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, vijoi takimin me punonjësën përgjegjëse të dhomave të shoqërimit që na u bashkua gjatë evidentimit të kushteve të ambienteve të Komisarariatit të Policisë Devoll.

Theksojmë se, punonjësit e Komisarariatit të Policisë Devoll me të cilët kontaktuam u treguan bashkëpunues gjatë komunikimit dhe inspektimit, që zhvilloi grupi i punës në ambientet e këtij institucioni. Në vijim, grupi i punës inspektoi ambientet e shoqërimit, disa zyra të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Në Komisarlatin e Policisë Devoll, nga informacioni i grumbulluar gjatë kryerjes së inspektimit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2021¹, rezultoi se:

1. **Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi**, për gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar rikonstrukcionin e përgjithshëm të godinës së Komisarlatit të Policisë Devoll me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjtoze, për personat e arrestuar, si dhe për personat e shoqëruar. Ndërkohë nuk kishte gjetur zbatim të plotë rekomandimi për të garantuar kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni.
2. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Devoll, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të dhe ndërtimin e një dhome shoqërimi për femra dhe një dhome shoqërimi për të miturit në konflikt me ligjin.
3. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në ambientin shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Devoll.
4. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për garantimin të kushteve higjieno-sanitare dhe pastërtisë së tualetit dhe të ambienteve të Komisarlatit të Policisë Devoll, si dhe lyerjen dhe dezinfektimin e vazhdueshëm të tyre.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se:

5. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e zyrave në Komisarlatin e Policisë Devoll ku merren në pyetje personat e shoqëruar dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këtë ambiente.
6. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
7. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.

Në përfundim të inspektimit, grupi inspektues vëren se megjithëse në Komisarlatin e Policisë Devoll ishin marrë masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe kushtet e tyre, nisur nga kushtet aktuale, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

¹ Dërguar rekomandimi nr. K166-2 prot, datë 17.12.2021 “Për inspektimin e kryer në ambientet e shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Devoll”.

Në Komisarjatin e Policisë Devoll, ambienti i shoqërimit ishte i ndërtuar përgjithësisht sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, ku parashikohet se: *“Dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit”*².

Komisariati i Policisë Devoll funksiononte në një godinë të vjetër, por të mirëmbajtur dhe dhoma e shoqërimit ishte e përshtatur brenda këtyre ambienteve, sipas kriterëve të parashikuara në procedurat standarde: *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*, miratuar me Urdhrin Nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit³.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve dhe ishin të pajisura me tavolina dhe stola të fiksuar në dysheme për të mundësuar qëndrimin ulur të personave. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4x4m me kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona.

Dhomat e shoqërimit kishin dritare, përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Dhomat gjithashtu, kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dera ishte prej druri, me mundësi për t’u mbyllur nga jashtë. Në përgjithësi dhomat ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare. Dhomat e shoqërimit nuk kishin sistem ngrohjeje/ftohjeje.

Në hyrje të korridorit të ambientit të shoqërimit ndodhej vetëm një tualet, i pajisur me çezmë dhe kishte ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje. Tualeti plotësohte kushtet higjieno - sanitare dhe ishte i pastër, por mungonte tualeti për femrat në ambientet e këtij komisarjati, duke mos u trajtuar sipas standardeve të përcaktuara në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019 “Për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, ku parashikohet se: *“Brenda këtyre ambienteve ose ngjitur me to, duhet të ketë tualete të ndara për femra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim”*⁴.

Në koridorin e ambientit të dhomave të shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. Gjithashtu në posterat përkatës ishte pasqyruar edhe e drejta ligjore e personave të shoqëruar për të paraqitur ankesa.

Në Komisarjatin e Policisë Devoll, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 06.07.2023 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **92** persona, ku të gjithë ishin shtetas madhorë, ndërsa shtetas të mitur dhe shtetase femra të shoqëruara në konflikt me ligjin nuk kishte gjatë kësaj periudhe.

² Kreu VII, pika 4/b e procedurave standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, parashikon, se kur nuk plotësohen këto standarde për mbajtjen e personave të shoqëruar në ambientet e policisë, krijohen kushte të nevojshme, të përshtatshme, të ndryshme nga ato të dhomave të sigurisë ku garantohen siguria dhe trajtimi njerëzor i tyre.

³ “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

⁴ Kreu VII, pika 4 e procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*.

Gjithashtu, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia informoheshin për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. Mekanizmi Kombëtar kërkon dhënien e kopjes së kartës së të drejtave që në momentin e hyrjes në komisariat, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat e tyre.

Nga verifikimi i regjistrit të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin **2023** nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Gjatë inspektimit nuk u konstatua asnjë rast, apo u administrua ndonjë ankesë lidhur me ushtrim dhune apo trajtim degradues nga punonjësit e policisë. Gjatë inspektimit u këqyrën të gjitha zyrat e oficerëve të Policisë Gjyqësore në të gjitha ambientet e komisariatit. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje.

Më tej u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të komisariatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisaratin e Policisë Devoll nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë të Korçës.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”⁵ dhe “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”⁶, parashikohet se: “*Cdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera edhe me regjistrat përkatës*”.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaratin e Policisë Devoll, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform parashikimeve ligjore të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*” dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësi i policisë në zyrën e informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

⁵ Kreu VII, pika 5 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

⁶ Kreu XI, pika 1 dh 3 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁷. Për rrjedhojë u konstatua se ishte plotësuar standardi për pasqyrimin me saktësi dhe përgjegjësi të rubrikave të librit të shoqërimit nga punonjësit e policisë të zyrës së informacionit.

Në këtë komisariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga verifikimi i këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë. Për këtë fakt, kërkua shpjegime dhe na u njoftua se asnjë nga personat e shoqëruar dhe të arrestuar nuk ka paraqitur ankesë me vullnet të plotë.

Nga inspektimi u konstatua se Komisarati i Policisë Devoll ishte pajisur me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë vitit 2023 nuk kishte pasur veprime për të miturit në konflikt me ligjin. Ky regjistër ishte hapur në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit, për marrjen e masave, për pajisjen e komisarateve të policisë me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin⁸.

Ambientet e intervistimit

Në Komisaratin e Policisë Devoll, nuk kishte dhomë më vete për marrjen në pyetje apo intervistimin e shtetasve të shoqëruar dhe të mitur. Oficerët e Policisë Gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera, për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore.

Në Komisaratin e Policisë Devoll mungonte dhoma e mbajtjes së provave materiale, në mungesë të saj oficerët e policisë gjyqësore, sendet të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale i mbanin në zyrat e tyre të cilat shërbejnë edhe për intervistimin e personave të shoqëruar/ndaluar.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse u përshkrua edhe më sipër, ky rekomandim nuk është zbatuar ende.

⁷ Kreu VIII “Procedura të Dokumentimit të Veprimit të Shoqërimit” parashikuar me Urdhrin Nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

⁸ Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare⁹, dhe atyre kombëtare e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

Sipas përcaktimit të kreut XIV, pika 6/b, të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019 për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, ku përcaktohet se: “Në dhomat e intervistimit/marrjes në pyetje të arrestuarve/ndaluarve për të regjistruar në elektronikë procesin e marrjes në pyetje apo veprime të tjera procedurale hetimore me të arrestuarit/ndaluarit”.

Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të ndaluar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

Ndërsa, mjediset e dhomave të shoqërimit, ambientet e brendshme dhe pjesa e jashtme e komisariatit, ishte e survejuar nga sistemi i kamerave përgjatë 24 orëve.

Komisariati i Policisë Devoll në kushtet aktuale nuk posedonte hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me persona të mitur. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht¹⁰.

Punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë.

⁹ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

¹⁰ CPT ka rekomanduar se duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të siguruar që e drejta për t’u informuar për ndalimin/arrestimin të garantohet në praktikë që nga fillimi i heqjes së lirisë. Sipas nenit 255/4 të Kodit Penal, policia informon familjen e personit të ndaluar/arrestuar pa vonesë. CPT ka rekomanduar që oficerët e policisë duhet të kenë parasysh që të lejojnë të ndaluarit/ arrestuarit të kenë qasje tek një avokat (e drejta për të pasur një avokat privat, të flasin me të dhe të jenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje) që nga fillimi i heqjes së lirisë dhe të garantojnë në praktikë këtë e drejtë. Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.21]. Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>

Ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, por dhe në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit Devoll. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Devoll ishte zhvilluar konform ligjit.

Në raste kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë në qendrën Shëndetësore Devoll, për të marrë ndihmën mjekësore.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut, i cili sigurohej në kohë përmes ndihmës nga shkolla e mesme e këtij qyteti, ose nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë dhe qëndronte i pranishëm derisa përfundonte procedura përkatëse.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Edhe në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “*Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit*”.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme, për gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar rikonstrukcionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Devoll, me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjitoze, si për personat e shoqëruar, ashtu edhe për të garantuar kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni.
2. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, ky ambeinte të jete i pajisur me

karamra audio/vizive si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisariatit¹¹.

3. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
4. Marrjen e masave për krijimin e dhomës për mbajtjen e provave materiale dhe largimin nga zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore të sendeve të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale.
5. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e një tualeti të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Përmet, për shtetaset gra të shoqëruara, ndaluara/arrestuara në konflikt me ligjin.
6. Marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e kartës së të drejtave në momentin në të cilin palët hyjnë në komisariat.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

Ahmet PRENÇI

¹¹ *Kreu VII, pika 4/d e Procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.*